



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR



PROCESVERBAL

**MBLEDHJA E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË APLIKIMEVE
(KVA) PËR GBP 2025**

17 tetor 2025

Hapja e mbledhjes

Z.Sonil Frashëri, Këshilltar/MSHPV në cilësinë e Kryetarit të Vlerësimit të Aplikimeve hapi mbledhjen e Komisionit të Vlerësimit për Grantin e Bazuar në Performancë. Në fjalën e tij hyrëse, ai falenderoi pjesëmarrësit për angazhimin e tyre dhe prezantoi përbërjen e komisionit si dhe pjesëmarrësit e pranishëm në këtë sesion. Më pas, i kaloi fjalën znj. Olta Caca, Drejtor i Drejtorisë së Statistikave dhe Performancës.

Znj. Caca paraqiti në mënyrë të strukturuar procedurën administrative që ndiqet sipas Udhëzimit të Përbashkët nr.01, datë 11.07.2025, për shqyrtimin e aplikimeve të dorëzuara nga bashkitë. Ajo theksoi gjithashtu rolin dhe përgjegjësitë e sekretariatit teknik në këtë proces. Më tej, znj. Caca bëri një shpjegim të detajuar të të gjithë kriterëve që duhen përmbushur për Planin e Barazisë Gjinore dhe vijoi me paraqitjen e rezultateve paraprake të verifikimeve mbi dokumentacionin e dorëzuar nga bashkitë. Znj. Sara Dema *specialist sektori i decentralizimit* solli në vëmendje rastet e bashkive Patos, Kolonjë dhe Bulqizë, të cilat kanë dorëzuar së fundmi dokumentacion shtesë (Procesverbali i VKB). Pas sqarimit të kërkuar nga znj. Adelina Farrici për këto bashki, komisioni u dakordësua për pranimin e tyre.

Gjatë diskutimeve të komisionit për kriteret e cilësisë së planeve, u trajtua çështja e mungesës së **paketës së emergjencës për viktimat e dhunës** në planet e barazisë gjinore, element të cilin përfaqësuesit e MSHMS Znj. Etleva Sheshi dhe Z. Xhenson Çela e konsideruan si kriter **thelbësor**, dhe si i tillë mungesa e **paketës së emergjencës për viktimat e dhunës** ul ndjeshëm efektivitetin praktik të planit. U theksua me shqetësim se të gjitha bashkitë, ndonëse të asistuar nga ekspertë, nuk e kishin përfshirë këtë komponent si kapitull të dedikuar. Z. Frashëri kërkoi që MSHMS të sqarojë peshën që kjo paketë ka në vlerësimin total. Ndërkohë, Znj. Farrici sugjeroi të lejohet një afat shtesë për dorëzimin e saj si dokument mbështetës. U ngritën mendime nëse këto elementë të paketës janë të përfshirë në plane të tjera si ai social, por u vu në dukje se ndryshimi i një plani të miratuar parashikon një procedurë komplekse. Znj. Valbona Karakaçi – HELVETAS/BtF, solli në vëmendje që kjo nismë mundë jetë tashmë e përfshirë **në planin social ekzistues**, dhe rrjedhimisht, mund të trajtohet në kuadër të politikave sociale të MSHMS. Në këtë kuadër z. Fran Brahimi theksoi rëndësinë e qëndrimit brenda kuadrit të dokumentacionit zyrtar dhe të udhëzimit.

Në vijim të diskutimeve, z. Erton Kashta nga HELVETAS/BtF propozoi që, për të bërë funksionale këtë paketë në kuadër të planeve për barazi gjinore, MSHMS mund të shqyrtojë mundësinë e një versioni minimal të saj, i cili të përfshihet në mënyrë të dedikuar në buxhetin vjetor. Komisioni diskutoi mbi alternativën e shqyrtimit të një forme të thjeshtuar të paketës, e cila të jetë e pranueshme dhe e zbatueshme. Znj. Caca propozoi që MSHMS të ofrojë një **vlerësim të treguesve të cilësisë**, për të kuptuar më mirë nëse janë përmbushur kriteret e cilësisë sipas udhëzimit. Në këtë kuadër, u soll si shembull praktika e ndjekur nga **Bashkia Bulqizë**, ku **u identifikuan disa masa konkrete** që konsiderohen pjesë e **një pakete emergjence për mbështetjen e viktimave të dhunës**.

Lidhur me rastin e **bashkive Has, Kukës dhe Tropojë**, u trajtua çështja e **aktit të konfirmimit nga Prefekti. Sekretariati teknik** sqaroi se bazuar në Aneksin 3 të Udhëzimit, akti i VKB duhet të jetë i konfirmuar nga Prefekti duke shprehur ligjshmërinë. Në këto raste, Prefekti nuk është shprehur për ligjshmërinë e aktit por ka cilësuar që nuk janë akte normative dhe si të tilla nuk përbëjnë objekt shqyrtimi nga ana e tij. Kjo kërkon vëmendje të theksuar nga ana e komisionit, dhe vlerësimin e tyre nëse do të quhet i përmbushur ose jo kriteri i aktit të konfirmimit nga Prefekti.

Çështja u hodh në votim:

- **Znj. Farrici** u shpreh **pro** pranimitt të dokumenteve;
- **Z. Frashëri, Z. Brahimi, Znj. Sheshi dhe Z. Çela** votuan **kundër**, duke u bazuar në mungesën e konfirmimit të ligjshmërisë nga Prefekti, sipas udhëzimit.

Mbyllja e Mbledhjes

Z.Frashëri, në referencë të diskutimeve të mësipërme, bëri një përmbledhje të përgjithshme dhe propozoi që të kualifikohen bashkitë që kanë parashikuar shumicë të masave konkrete si pjesë e një pakete emergjence, dhe përmbushin kriteret teknike, ndërsa për vitin pasardhës të kërkohet përfshirja buxhetimit për zbatimin e një pakete emergjente të viktimave të dhunës. Të gjithë anëtarët e komisionit u dakordësuan me këtë propozim.

VERIFIKIMI SIPAS SUGJERIMEVE TË KVA-SË.

Sekretariati Teknik ndoqi sugjerimet e KVA-së dhe më poshtë do të gjeni shqyrtimin e dokumentacionit për Planin e Barazisë Gjimore nga Sekretariati Teknik – AMVV.

- Totali i aplikimeve → **37 bashki**
- VKB (brenda afatit) → **34 bashki**
- Dokumenti i Planit (brenda afatit) → **34 bashki**
- Lidhja e publikimit në faqen zyrtare → **34 bashki**
- Procesverbali VKB → **31 bashki**
- Akti i konfirmimit nga Prefekti → **31 bashki**

Bashkia	Dokumenti Planit	VKB (1 janar-17 shtator)	Publikimi VKB	Procesverbali	Akti i Prefektit	5 Kriteret
Polican	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Bulqizë	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Dibër	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Mat	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Klos	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Shijak	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Elbasan	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Gramsh	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Librazhd	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Peqin	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Prrenjas	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Divjakë	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Lushnje	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Patos	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Roskovec	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Dropull	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Gjirokastër*	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Memaliaj	✓	✗	✗	✗	✗	✗

Përmet	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Korçë	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Maliq	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Pogradec	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Pustec	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Kolonjë	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Has**	✓	✓	✓	✓	✗	✗
Kukës**	✓	✓	✓	✓	✗	✗
Tropojë**	✓	✓	✓	✓	✗	✗
Lezhë	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Fushë-Arrëz	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Malësi e Madhe	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Kamëz	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Vorë	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Delvinë	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Finiq	✓	✗	✗	✗	✗	✗
Himarë	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Konispol	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Sarandë	✓	✓	✓	✓	✓	✓

* Bashkia Gjirokastrë rezulton me miratimin e Planit nga Këshilli Bashkiak jashtë afatit të përcaktuar, sipas [Udhëzimit të Përbashkët Nr.01, datë 11.07.2025](#).

** Prefekti është shprehur se Vendimi i Këshillit Bashkiak “Për miratimin e planit të barazisë gjinore” nuk është akt normativ dhe si i tillë nuk është objekt shqyrtimi i tij.

VLERËSIMI PARAPRAK NGA KVA MBI KUALIFIKIMIN E BASHKIVE PËR PLANIN E MBARËSHTIMIT

Vlerësimi i KVA për Planin e Barazisë Gjinore		
Nr.	Bashkia	Kualifikohet dhe në përputhje me kriteret e cilësisë sipas Aneksit 3 (Po/Jo)
1	Poliçan	Po
2	Bulqizë	Po
3	Dibër	Po
4	Mat	Po
5	Klos	Po
6	Shijak	Po
7	Elbasan	Po
8	Gramsh	Po
9	Librazhd	Po
10	Peqin	Po
11	Prrenjas	Po
12	Divjakë	Po
13	Lushnje	Po
14	Patos	Po
15	Roskovec	Po
16	Dropull	Po
17	Gjirokastër	Jo
18	Memaliaj	Jo
19	Përmet	Po
20	Korçë	Po
21	Maliq	Po
22	Pogradec	Po
23	Pustec	Po
24	Kolonjë	Po
25	Has	Jo
26	Kukës	Jo
27	Tropojë	Jo
28	Lezhë	Po
29	Fushë-Arrëz	Po
30	Malësi e Madhe	Po
31	Kamëz	Po
32	Vorë	Po
33	Delvinë	Po
34	Finiq	Jo
35	Himarë	Po
36	Konispol	Po
37	Sarandë	Po

Lista e anëtarëve të KVA				
Treguesi: Plani Vendor për Barazine Gjinore				
Nr.	Institucioni	Emër	Mbiemër	Pozicioni në KVA
1	MSHPV	Sonil	Frashëri	Kyetar
2	SHKBSH	Adelina	Farrici	Anëtar
3	MF	Fran	Brahimi	Anëtar
4	MSHMS	Etleva	Sheshi	Anëtar
5	MSHMS	Xhenson	Cela	Anëtar